Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 561/01
Datë 11.12.2014

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/14- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 11.12.2014 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për akreditimin e English Language Center në Prishtinë, për periudhën 1 vjeçare, 11. 12. 2014 deri 11.12. 2015 për:

1.1. Gjuhë angleze

Akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

1. Duhet të emërohet Zyrtari për Sigurim të Cilësisë dhe të sigurohet trajnimi i tij
2. Dokumentacioni i plotë lidhur me politikat, procedurat, normat dhe rregullat për sigurimin e cilësisë (të ofrohen dëshmi për këtë)
3. Trajnime për atë se çka kërkohet gjatë procesit të akreditimit
4. Paraqitja e planit 5-vjeçar të zhvillimit AKK-së (prej vitit 2015 e tutje)
5. Trajnime profesionale për stafin mësimdhënës
6. Të sigurohen dëshmi të politikës mbi zhvillimin profesional të shkathtësive të mësimdhënies të cilat mbështeten në Udhëzuesin e AKK-së dhe të sistemeve efektive për implementimin e kësaj politike.
7. Pronarja/Drejtoresha/Koordinatorja/Mësimdhënësja duhet ta qartësojë rolin e saj.

8. Certifikatat që u lëshohen kandidatëve në mbarim të nivelit duhet ta kenë përshkrimin e kompetencave gjuhësore mbështetur në Kornizën e Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët (KPERGJ).
9. Të qartësohet marrëdhënia me OJQ Happy kids (të ofrohen dëshmi për këtë, psh. Memorandum bashkëpunimi).
10. Nxënësve dhe stafit në të gjitha qendrat duhet t'u bëhet e ditur procedura mbi evakuimin në rast të zjarrit. Në Q2 duhet të vendosen shenjat për dalje emergjente.

Afati kohor për plotësimin e të gjitha këtyre kushteve është 31.05.2015.

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit me datë: 13.11.2014, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Raportin e Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
Raporti i Vetë-vlerësimit;
Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
Dokumente tjera shtesë.

Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë.
Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi i dërgohet:
- English Language Center në Prishtinë; dhe
- AKK.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi